February, 21… 2015

# University of Durrës

## Students Initiative against Corruption in Public Universities, Albania

# Report 2

MJAFT!

Diskutimet publike në kuadër të Iniciativës Studentore Kundër Korrupsionit në Universitetet Publike vijuan në Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu”, më datë 21 Shkurt 2015. Gjatë ditës u realizuan 2 (dy) takime. Së pari, u zhvillua në Universitet, me një numër rreth 150 (njëqind e pesëdhjetë) studentësh pjesë e diskutimit. Së dyti, me një grup më të vogël studentësh, të cilët janë dhe aktivistë të CSDC Durrës, pranë zyrave të kësaj të fundit u zhvillua një bisedë më e fokusuar në pikat si më poshtë:

- Llojet e Korrupsionit për ju…
- Liria e fjalës dhe e veprimit…
- E drejta për informacion…

Tre pikat më lart, merrni kuptim dhe parashtroheshin nga studentet për target grupet:

- Student – Këshilli Studentor në Fakultet
- Staf Akademik
- Staf Administrativ
- Kupolat drejtuese

Pasi treguam Qëllimet dhe Pritshmeritë e Projektit të cilat në rastin konkret u parashtruan shkurt:

- Ψ *Rezultate*
  - Ndërgjegjësim
  - Nxitje në raportim
  - Çeshtje Konkrete
  - Punim Kërkimor
  - Mediatizim

- Ψ *Pse?!*
  - Paqëndrueshmëria në sistemin universitar,
  - Perceptime apo të vërteta,

Arsimi: “Whatever the cost of our libraries, the price is cheap compared to that of an ignorant nation.”
― Walter Cronkite

Gjatë takimit me student në Universitet, të pranishmit ishin tërësisht të Sistemit Part-time. Ishte lehtësisht i dallueshëm heterogjeniteti i grupit, për nga mosha, profilet nga vinin dhe nga kërkesat për studimet universitare. Pjesëmarrësit ishin të shumtë në numër e kështu problematikat, apo ndryshe rastet korruptive aprovoheshin lehtë në sallë.

Që në fillim, studentët u shprehën të pakënaqur me transportin, i cili deri vitin e kaluar ishte në dispozicionin e tyre, e tani, jo më. Ky rast përbën problem, pasi parimisht, si kosto, në ndërtimin e Universitetit, supozohet që ekziston Zëri në Buxhet, përkatës për mbulimin e transportit. Studentët tregojnë që për ta, kosto ditore e transportit për të ndjekur orët mësimore janë mesatarisht 300 lek të reja. Këtu nuk duhet të harrojmë orët e sakrifikuara në pritje të mjeteve të transportit.

Diskutimi vijoi me mungesën e Entiteteve Përfaqësuese Studentore, si Këshilli Studentor. Dukshëm vërtetohej që nuk kishte një të tillë. Për më tepër, ata treguan që nëse replikonin për diçka që atyre u takonte e nuk u ofrohej në Universitet, do të kishin pasoja të mëtejshme të cilat më tepër shfaqeshin në mungesën e etikës së komunikimit, që mund të shkonte deri në dhunim psikologjik ndaj studentit.

Studentët, ndjekës të rregullt të orëve mësimore, tregonin shqetësim për faktin që ekzistonte një numër mjaftueshëm i konsiderueshëm studentësh të cilët nuk frekuentonin gjatë vitit, e në fund kishin rezultate të kënaqshme. Për ta ishte trajtim i pabarabartë dhe për më shumë linte hapësira për të menduar se si këta mund të thyenin rregullat pa penalitetet përkatëse.

Shqetësim përbënte gjithashtu situata për Lëndët me Zgjedhje. Studentët nuk kishin të drejtën e seleksionimit të lëndës sipas kërkesave të tyre. Për ta, kjo ndodhte, si pasojë e mungesës së ekspertizës për programet e degëve përkatëse.

Nuk mund të anashkalohej rasti në të cilin studentët, pa përjashtim, kanë paguar 200 lek të reja për sigurimin e Kartës së Studentit. Kjo e fundit akoma nuk është dhënë e siç studentët tregojnë, nuk dine as përfitimet nga kjo Kartë.

Pagesa për provime
…

Higjiena rrotull Universitetit
…

Paqëndrueshmëria e Profesorëve
…

Sekretaria
…

*Shënime:*

# INICIATIVA ËSHTË PROGRES

## STUDENTËT KUNDER KORRUPSIONIT NE UNIVERSITETET PUBLIKE



MJAFT!

Publikimi i këtij materiali është mbështetur finaciarisht nga Programi i Granteve te Vogla i Komisionit per Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura ne këtë botim janë te autor-it/ve dhe nuk përfaqësojne domosdoshmërisht ato të Departamentit te Shtetit.